

VENDIM
Nr.387, datë 28.6.2007

**PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.121, DATË 15.3.2001 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR RREGULLAT E SIGURIMIT FIZIK TË
INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 25 e 31 të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.121, datë 15.3.2001 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Në fund të pikës 3 të kreut I, “Rregulla të përgjithshme”, pas fjalëve “... drejtuesi i institucionit...” të shtohen:

“..., në përputhje me klasifikimin e zonave të sigurisë, si më poshtë vijon:

a) Zona e sigurisë e klasit të parë është zona, ku ruhet dhe administrohet informacioni i klasifikuar “Konfidencial” e lart. Kjo zonë ka të kontrolluar regjimin e hyrje-daljeve dhe të lejuar vetëm për personat e autorizuar.

b) Zona e sigurisë e klasit të dytë është zona, ku ruhet dhe administrohet informacioni i klasifikuar “Konfidencial” e lart. Kjo zonë, veç masave të mësipërme, mbrohet nga akseset e personave të paautorizuar edhe nëpërmjet kontrolleve të brendshme, të rrepta dhe të përforcuara.

c) Zona administrative është zonë, e cila ngrihet përreth zonave të sigurisë së klasit të parë dhe të klasit të dytë. Kjo zonë kërkon një perimetër të përcaktuar, brenda të cilit të ekzistojë mundësia për kontrollin e personave dhe të mjeteve. Në këtë zonë trajtohet vetëm informacioni i klasifikuar “I kufizuar”.”.

2. Në pikën 6 të kreut II, “Për sigurimin fizik”, pas fjalës “... përcaktojnë...” shtohen “...planin dhe skemën e sigurisë fizike të objektit, ku mbahet e administrohet informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror”...”.

3. Në kreun 3, “Sigurimi me roje”, bëhen këto shtesa:

a) Pas fjalisë së parë të pikës 2, të shtohet kjo fjali:

“Rojat duhet të jenë të pajisura me “Certifikatë sigurie”, të përshtatshme.”.

b) Në pikën 8, pas fjalës “...armatosura.” shtohen “...që duhet të jenë të pajisura me “certifikatë sigurie”, të përshtatshme.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha